



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E MALISHEVËS
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport



Për nder të shënimit të 16 Qershorit-Ditës së Çlirimit dhe të Dëshmorëve të Malishevës, Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, shpall:

KONKURS

a) Krijime letrare

Poezi (vendi i parë 150 €, vendi i dytë 100 €, vendi i tretë 50 €).

b) Arti Pamor

Pikturë (vendi i parë 300 €, vendi i dytë 200 €, vendi i tretë 100 €).

c) Arti muzikor

Këngë (vendi i parë 150 €, vendi i dytë 100 €, vendi i tretë 50 €).

Kushtet:

- Të gjitha krijimet të jenë me motive kryesisht nga lufta e UÇK-së dhe ngjarje e peizazhe nga territori i Komunës së Malishevës.
- Poezitë duhet të dorëzohen me shifër,
- Pikturat duhet të dorëzohen me emër dhe mbiemër të autorit
- Këngët duhet të dorëzohen me emër dhe mbiemër të këngëtarit dhe me kopje në CD.

Punimet duhet të dorëzohen në zyrën e drejtorit të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.

Të drejtë konkurrimi kanë të gjithë artistët brenda dhe jashtë komunës së Malishevës.

Tri punimet fituese nga tri zhanret konkurruese nuk kthehen.

Shpallja e rezultateve bëhet më 16 qershor për nder të Ditës së Çlirimit dhe të Dëshmorëve të Malishevës.

Për informata shtesë kontaktoni në e-mail: dkrs_malisheva@hotmail.com dhe në këtë numër telefoni 044 296 656.

Konkursi është i hapur prej datës 18 maj deri më 3 qershor 2011.